

Zhvillimet në Sektorin e Jashtëm të Ekonomisë për Gjashtëmujorin e Parë të Vitit 2003

Bilanci i pagesave, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2003 është karakterizuar nga këto zhvillime kryesore:

- Rritje e fluksit të shkëmbimeve korente.
- Thellim i deficitit korent.
- Rritje e njëkohshme e detyrimeve dhe mjeteve tona financiare ndaj botës e shoqëruar me rritjen e rezervave të autoritetit monetary.

Gjashtëmujori i parë është karakterizuar nga një forcim i monedhës europiane kundrejt dollarit amerikan. Ky zhvillim ka bërë që llogaritjet e bilancit të pagesave të mbartin një efekt të theksuar të kursit të këmbimit.

Në fund të gjashtëmujorit të parë deficitit i përbashkët prej 633 milionë usd i tregtisë së jashtme dhe i shërbimeve nuk mund të mbulohej prej suficitit prej 422 milionë usd në kategoritë 'të ardhura nga puna' dhe 'transferta korente'. Deficitit korent prej 210 milionë usd u financua pjesërisht prej hyrjeve kapitale dhe financiare, të cilat kapën shifrën 158 milionë usd. Pjesa më e madhe e këtyre hyrjeve kanë ardhur në formën e investimeve direkte, të cilat ishin 64 milionë usd ose 11 milionë usd më të larta se ato të gjashtëmujorit të parë të vitit të kaluar, si edhe në formën e huamarrjes zyrtare nga jashtë, e cila shënoi shifrën 59 milionë usd. Si rezultat detyrimet tona financiare u rritën me 129 milionë usd duke qenë rreth 48 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar.

I. LLOGARIA KORENTE

Fluksi i shkëmbimeve korente të Shqipërisë me botën, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2003, kapi shifrën 2.2 miliardë usd, e cila është 26 për qind më e lartë se një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së shkëmbimeve tregtare në mallra dhe në shërbime.

Deficitit korent në fund të gjashtëmujorit të parë arriti nivelin 210 milionë usd, prej të cilit rreth $\frac{3}{4}$ janë regjistruar gjatë tremujorit të dytë të vitit. Thellimi i deficitit korent ka ardhur si pasojë e rritjes së deficitit tregtar, ndërkohë që lëvizjet në zërat e tjerë të llogarisë korente - shërbimet, të ardhurat dhe transfertat korente - kanë tentuar drejt ngushtimit të deficitit korent. Shkëmbimet tregtare gjatë këtij gjashtëmujori, si në importe ashtu edhe në eksporte, kanë shënuar rritje.

a) Bilanci tregtar

Vëllimi i përgjithshëm tregtar gjatë periudhës u vlerësua në **1 miliardë e 70 milionë usd** ose rreth **246 milionë usd** më i lartë se ai i të njëjtës periudhë për vitin 2002. Importet e kësaj periudhe, duke shënuar **848 milionë usd**, i tejkaluan ato të vitit të kaluar¹ me rreth **25 për qind**, ndërkohë që eksportet, pavarësisht nga rritja prej 50 për qind, nuk arritën të ngushtonin deficitin tregtar. Ky i fundit, në mbyllje të gjashtëmujorit, ishte **626 milionë usd**. Aktiviteti

¹ I referohemi gjithnjë gjashtëmujorit të parë.

tregtar ka qenë më i vullshëm gjatë tremujorit të dytë, sidomos në krahun e importeve, dukuri që është vërejtur edhe gjatë vitit të kaluar.

Rritja në importe është vërejtur në të gjitha grupproduktet tregtare, por efektin më të madh në rritjen e importeve kundrejt gjashtëmuja të parë të vitit të kaluar e ka dhënë **kërkesa e lartë për importet e makinerive dhe pajisjeve**, për importet për përpunim aktiv si edhe për importet e mallrave ushqimorë. Ndërsa vëllimeet e rritura të importeve mbartin në vetvete edhe tendenca pozitive, që shfaqen në rialokimin e burimeve financiare në ekonomi, vëllimet e eksporteve vazhdojnë të mbeten në nivele të ulëta, duke demonstruar shkallën e ulët të ristrukturimit të ekonomisë.

Rritja e eksportit këtë gjashtëmuja ka ardhur kryesisht nga rritja në riekporte (industri e veshjeve tekstile dhe e atyre të këmbëve). Gjithashtu, në rritje paraqitet eksporti nga prodhimi i brendshëm i përqëndruar kryesisht në eksportin e ferrokromit. Megjithatë, niveli i përfaqësimit të eksportit të brendshëm në totalin e eksporteve mbetet në rreth 21 për qind.

b) Shërbimet

Bilanci i shërbimeve, edhe pse me një deficit prej **7.2 milionë usd**, ka rezultuar më pak negativ se ai i vitit të kaluar, kryesisht për shkak të rritjes së të ardhurave nga shërbimet e transportit. Eksportet e shërbimeve, që kapin nivelin **301 milionë usd**, janë përfaqësuar në pjesën më të madhe, nga të ardhurat prej turizmit, ndërkohë që shpenzimet për shërbime, pra importet, që qëndrojnë në nivelin **308 milionë usd**, janë përqëndruar në turizëm dhe transport.

Në krahasim me vitin e kaluar, në kategorinë e shërbimeve vihet re një rritje si në të ardhurat, ashtu edhe në shpenzimet për turizëm, të cilat përfaqësojnë **respektivisht 70 për qind të eksporteve dhe 58 për qind të importeve të shërbimeve**. Aktiviteti i turizmit ndikon pozitivisht në rritjen e eksporteve të shërbimeve dhe është një nga burimet kryesore të sigurimit të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare. Këtë gjashtëmuja ato vlerësohen të jenë rreth **21 milionë usd** më të larta se një vit më parë. Megjithatë, në krahasim me vitin e kaluar, vërehet se pesha e të ardhurave nga turizmi ndaj të ardhurave të përgjithshme nga shërbimet ka rënë si pasojë e rritjes së të ardhurave nga shërbimet e transportit, nga ato të telekomunikacionit dhe nga ato financiare. Shërbimet e transportit të mallrave kanë pësuar ndryshime sidomos në kahun e të ardhurave prej transportit të realizuar nga kompanitë rezidente, të cilat kapin shifrën **25 milionë usd**².

c) Të ardhurat

Ekonomia shqiptare përfiton të ardhura në valutë prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, dhe njëkohësisht paguan interesat për borxhin e jashtëm. Rezultati neto i transaksioneve në të ardhura mbetet pozitiv edhe gjatë këtij gjashtëmuja.

Të ardhurat nga puna në krahasim me gjashtëmuja të parë të vitit të kaluar janë rritur me rreth **14 milionë usd** duke arritur nivelin prej **83 milionë usd**. Gjithashtu, rritje kanë regjistruar edhe të ardhurat nga interesat e mbledhur nga investimet e portofolit të institucioneve rezidente jashtë. Të ardhurat nga interesat prej investimit të rezervës tonë valutore në institucione jorezidente janë më të ulëta se ato të vitit të kaluar.

d) Transfertat korente

Bilanci i transfertave korente në fund të gjashtëmuja të parë ishte pozitiv dhe rreth **12 për qind më i lartë** se ai i gjashtëmuja të parë të vitit të kaluar. Peshën kryesore (rreth 96 për qind) të të ardhurave në këtë kategori vazhdojnë ta zënë transfertat e emigrantëve shqiptarë me

² Ndryshimet në këtë vlerësim kanë ardhur prej fillimit të aplikimit në llogaritjet e bilancit të pagesave të kostos së re të transportit, e cila është rritur në 12 për qind nga 7 për qind që aplikohet në vitet e mëparshme.

banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe këto transferta kanë arritur nivelin **366 milionë usd** duke qenë **18 për qind më të larta** se ato të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Tremujori i parë, ashtu si edhe gjatë dy viteve paraardhëse, ka regjistruar transferta më të larta (rreth 20 milionë usd) se tremujori i dytë. Këto transferta kanë financuar rreth 50 për qind të deficitit në mallra dhe shërbime për gjashtëmujorin e parë.

II. Llogaria kapitale dhe financiare

Flukset neto të kapitalit, gjatë këtij gjashtëmujori, regjistruan rreth **158 milionë usd**. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale hyrëse prej rreth 67 milionë usd dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth **90 milionë usd**.

Bilanci pozitiv i llogarisë financiare është realizuar kryesisht prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe disbursimit të kredive nga jashtë. Këto lëvizje çuan në rritje të detyrimeve financiare. Në këtë rritje rol kryesor luajtën disbursimet e kredive të huaja, të cilat e rritën borxhin e jashtëm të Shqipërisë me **59 milionë usd**, si dhe flukset e investimeve të huaja direkte të cilat kapën shifrën **64 milionë usd**. Investimet e huaja direkte, mbeten një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare si edhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare. **Rritja e fluksit të investimeve të huaja direkte, me rreth 21 për qind kundrejt periudhës korresponduese të vitit 2002**, reflekton kryesisht aktivitetin e kompanive të huaja për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës, si dhe aktivitetin e kompanive të telefonisë celulare në vend. Gjithashtu, detyrimet financiare në formën e depozitave të bankave të huaja jorezidente në sistemin tonë bankar janë rritur me **7.4 milionë usd**.

Mjetet tona financiare janë rritur me 38.4 milionë usd. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes në investimet e portofolit tonë jashtë, gjë që është vërejtur kryesisht në tremujorin e parë, si edhe prej rritjes së mjeteve valutore në *cash*, me 21 milionë usd, gjatë tremujorit të dytë.

Mjetet financiare në formën e investimeve të portofolit arritën në shumën prej rreth 126 milionë usd duke shënuar një rritje përgjatë gjashtëmujorit prej 4.5 milionë usd. Investimet e portofolit në Usd përbëjnë rreth 86 për qind të investimeve totale të portofolit.

Depozitat e sistemit bankar në institucione të huaja kanë rënë me 8.7 milionë usd gjatë tremujorit të parë dhe janë rritur me 8 milionë usd gjatë tremujorit të dytë duke bërë që gjashtëmujori të mbyllet pa lëvizje të dukshme në këtë kategori.

Rezervat e autoritetit monetar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit u rritën me rreth 61 milionë usd, rritje që erdhi plotësisht nga rritja në mjetet valutore. Kjo rritje është mjaft më e lartë se rritja prej vetëm 8 milionë usd në rezervat valutore gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2002. Stoku i rezervave vlerësohet në **934.8 milionë usd** dhe mbulon **4.8 muaj importe** të mallrave dhe shërbimeve, nga 5.1 muaj importe që ishte koeficienti i llogaritur për gjashtëmujorin e parë të vitit 2002.

Bilanci i Pagesave

në milionë dollarë amerikanë

	6m-I 2002	3m-I 2003	3m-II 2003	6m-I 2003
Llogaria Korente	-181.2	-56.1	-153.9	-210.0
Eksporti i mallrave	148.1	108.6	113.7	222.3
Importi i mallrave	-675.9	-394.1	-453.8	-847.9
Bilanci Tregtar	-527.8	-285.5	-340.1	-625.6
Shërbimet: Kredi	225.9	127.5	173.8	301.3
Shërbimet: Debi	-249.8	-118.5	-190.1	-308.6
Të Ardhurat: Kredi	69.1	36.6	46.3	82.9
Të Ardhurat: Debi	-12.2	-4.5	-6.2	-10.7
Transferta Private Pashpërblim	293.2	180.2	154.3	334.5
Transferta Shtetërore Pashpërblim	20.4	8.1	8.0	16.1
Llogaria Kapitale	54.7	31.0	36.5	67.5
Llogaria Financiare	132.6	47.9	42.3	90.2
Investime Direkte	53.0	27.0	36.9	63.9
Investime Portofoli	-26.8	-11.4	6.8	-4.5
Kapitale të Tjera*	101.1	26.8	-1.4	25.4
Gabime dhe Haresa Neto	2.1	34.2	79.4	113.6
Bilanci i Përgjithshëm	8.2	57.0	4.2	61.2
Rezervat dhe Zëra të Lidhur me to.				
Mjetet e Rezervës	-8.2	-57.0	-4.2	-61.2
Përdorim Huash e Kredish nga FMN	5.3	5.5	0.0	5.5
Për t'u Mbajtur në Vëmendje				
Ndryshimi Total në Rezerva	-43.6	-61.0	-32.7	-93.7
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	42.2	12.5	22.1	34.7

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN